

## **Metodologjia e Reformes Zgjedhore prioritetet, axhenda dhe organizimi I punes**

Reforma zgjedhore duhet te mbyllet brenda dates 15 mars 2020. Koha e shkurter ben te domosdoshme qe ceshtjet per debat te vendosen ne rend prioritar me afate te qarta. Per kete sherbejne rekomandimet e ODIHR.

Kalendari i temave qe duhen trajtuar nga grupi i kater perfaqesuesve politike dhe ekspertet, sipas autorizimit nga Keshilli Politik, paraqiten si me poshte:

<b>Tema</b>	<b>Afati</b>
<b>Propozime per parandalimin dhe goditjen e krimeve zgjedhore,</b> perfshire masa per rolin e policise, prokurorise dhe gjykateve ne procesin zgjedhor kunder shitblerjes se votes, presionit mbi zgjedhesit dhe administraten, cenimit te sekretit dhe lirise se votes dhe abuzimi me burimet shtetore;	10 shkurt 2020
<b>Ndarja e politikës nga krimi, nepermjet forcimit e zbatimit te procesit te dekriminalizimit me masa shtese</b>	10 shkurt 2020
<b>Propozime per perfshirjen e teknologjise ne zgjedhje.</b>	20 shkurt 2020
<b>Propozime per financimin e fushates zgjedhore, si dhe financimin e partive politike jashte fushates.</b>	15 shkurt 2020
<b>Propozime ne lidhje per gatitjen e listave te zgjedhesve, pajisjen me karta ID, si dhe parandalimin e votimit fiktiv te emigrantëve.</b>	5 shkurt 2020
<b>Propozime per rolin e mediave ne fushate.</b>	15 shkurt 2020
<b>Propozime per parandalimin e abuzimit me burimet shtetore dhe administraten publike ne periudhen zgjedhore.</b>	15 shkurt 2020
<b>Propozimet mbi panshmerine e administrates zgjedhore ne te gjitha nivelet</b>	1 mars 2020
<b>Propozime per sistemin e ankimeve gjyqesore dhe administrative</b>	25 shkurt 2020
<b>Propozime per sistemin zgjedhor.</b>	10 mars 2020
<b>Propozime per votimin nga jashte vendit.</b>	1 mars 2020
<b>Ceshtjet qe lidhen me barazite gjinore, regjistrimin e subjekteve, periudhen zgjedhore</b>	3 shkurt 2020
<b>Ceshtje te tjera teknike qe reflektojne ndryshimet e imponuara nga pikat e mesiperme</b>	15 mars 2020

**Parakusht qe keto masa te jene efikase, eshte krijimi i nje fushe loje te barabarte nepermjet zbatimit te plote te parimit te “ndarjes se shtetit nga partite politike” ne perputhje me Angazhimin e OSBE-se te parashikuar nga paragrafi 5.4 i Dokumentit te Kopenhagenit.**

Ne menyre qe reforma te konsiderohet si e suksesshme nga ODIHR, ajo duhet qe te trajtoje sa me gjeresisht rekomandimet e ODIHR. Disa ceshtje mund te kerkojne me shume kohe, si ceshtja e referendumeve dhe ligji per financimin e partive politike apo mund te prekin kushtetuten dhe kerkojne nje debate me te gjere apo rruge miratimi tjeter. Pavaresisht prioriteteve te shprehura nga palet, grupi i eksperteve duhet te filloje menjehere nga puna per ceshtjet per te cilat palet bien dakord se duhen trajtuar me prioritet ne menyre te menjehershme, nderkohe qe ceshtjet e tjera mbeten per t’u diskutuar me tej ne nivel politik ne Keshillin Politik dhe/ose grupin katersh te perfaqesuesve politike.

Ekspertet e Komisionit I Reformes Zgjedhore kane hartuar draftet per nje pjese te madhe te ceshtjeve te parashikuara ne kalendar por qe nuk reflektojne komentet dhe propozimet e opozites jashteparlamentare apo qe nuk jane dakordesuar me te.

Per kete qellim per te gjitha ceshtjet ne kalendar perfaqesuesit e opozites jashte-parlamentare duhet te sjellin propozimet ne forme te drafteve ligjore dhe zgjidhjeve alternative te mundeshme dhe ne perputhje me standardet e ODHIR per zgjedhje te lira e te ndershme. Ne kete aspekt dunet shfrytezuar puna e bere ne draftim deri me sot nga ekspertet e opozites.

Per ceshtjet qe do te kete dakordesi te plote dhe te pergatitura ne nivel teksti ligjor te dakordesuar, draftet do te dergohen per opinion paraprak tek ODHIR.